



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2005/prot.  
3

Tiranë, më 23/12 2019

**V E N D I M**

Nr. 42 datë 23.12 2019

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE ME MESATARE MBI 6  
QË JU REDUKTOHET TARIFA E SHKOLLIMIT 50%,  
PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE**

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikës së Shqipërisë", VKM nr. 778 datë 26.12.2018 "Për një ndryshim dhe shtesë në VKM nr. 288 datë 21.05.2018" Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të integruar të studimeve ose një një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" të ndryshuar, të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.26 datë 18.07.2019 "Mbi miratimin e tarifave të regjistrimit për aplikim, konkurim, regjistrimit të fituesve, tarifave të shkollimit për të dy ciklet e studimeve, në Universitetin e Sporteve të Tiranës", shkresa e FSHL nr. 2006 datë 09.10.2019 dhe shkresa e FVFR nr. 2006/1 datë 09.12.2019, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë listën e studentëve të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, me mesatare mbi 6 (gjashtë), që përfitojnë reduktim 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2019-2020, sipas shtojcës 1 bashkëngjitur
2. Të miratojë listën e studentëve të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, me mesatare mbi 6 (gjashtë) që përfitojnë reduktim 50% nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2019-2020, sipas shtojcës 2 bashkëngjitur
3. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë nga ulja 50% e tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2019-2020 dhe me efektet financiare të dërgohen në MASR.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Hysen Domi**

